



Ambasciata d' Italia
Prishtina

VIZE PER BIZNES

Viza për BIZNES lejon hyrjen në Itali, si destinacion kryesor, si dhe eventualisht në hapësirën territoriale të Shteteve tjera Schengen, për qëllime ekonomike dhe tregtare.

Çdo banor i Kosovës i cili kërkon vizë hyrjeje në Itali për Biznes duhet të paraqitet personalisht pranë Sportelit të vizave të Ambasadës Italiane në Prishtinë në ditën e në orën e caktuar dhe t'i dorëzojë personelit përkatës "Formularin e kërkesës për vizë" me dy fotografi aktuale sipas standardit ICAO, të mbushur në të gjitha pjesët e tij me shkronja të mëdha shtypi. Kërkesës për vizë duhet t'i bashkëngjiten dokumentet e poshtë shënuar si edhe një fotokopje e qartë e tyre:

1) Pasaportë të vlefshme të paktën deri në skadimin e afatit të vizës së kërkuar;

2) Dokumente që vërtetojnë regjistrimin e Firmës vendoren Kosovë si operator ekonomik-tregtar (në origjinal dhe të fotokopjuara): Certifikata e Biznesit, Informata mbi Biznesin, Certifikata e TVSH-së, Certifikata e Shërbimit Doganor, Certifikata mbi Numrin Fiskal, Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës (origjinal) ku të vërtetohet që Firma nuk rezulton të jetë debitore;

3) Dokumente që vërtetojnë qëllimin e udhëtimit si edhe të qëndrimit në Itali: Ftesë nga Kompania italiane me të cilën mbahen raporte të rregullta tregtare (Lettera d'Invito per Motivi di Affari) e nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i Firmës dhe e shoqëruar nga një dokument identifikimi i vlefshëm i përfaqësuesit italian.

Ftesa duhet dërguar në adresën elektronike e-mail visti.pristina@esteri.it dhe duhet shoqëruar nga Informatat mbi Biznesin të Firmës Italiane të lëshuar në datë jo më të hershme se 6 muaj (Visura Camerale).

Për informata më të hollësishme mund të konsultoni faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme: www.esteri.it/visti

KUJDES:pavarësisht dërgimit të Ftesës nga Kompania italiane ftuese (në adresën elektronike të lartpërmendur) Ju duhet të keni një kopje të saj gjatë procesit të aplikimit;

4) Dokumente eventuale që vërtetojnë marrëdhëniet ekonomike-tregtare me Kompaninë italiane: Faturat dhe DUD-at e 4 importeve të fundit (origjinal dhe fotokopje);

5) Dokumente që vërtetojnë adresën gjatë qëndrimit në Itali: konfirmim i rezervimit të hotelit – nëse nuk është saktësuar në Ftesë;

6) Dokumente që vërtetojnë situatën sociale dhe profesionale në Kosovë:

- **VETEM PER PUNETORET ME KONTRATE:** kontrata e punës, vërtetim i punëdhënësit ku të tregohen qartë: data e fillimit të marrëdhënies së punës, kualifikimi profesional dhe rroga mujore si edhe një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore ku të vërtetohet derdhja e kontributeve pensionale dhe tatimit mbi paga;

7) Dokumente që vërtetojnë situatën ekonomike dhe financiare në Kosovë:

- pasqyrë përmbledhëse bankare ORIGJINALE (jo e fotokopjuar apo e skanerizuar) e llogarisë Tuaj (personale/ familjare/e biznesit) e lëshuar nga banka përkatëse në datë jo më të hershme se 6-muaj;
- fotokopje të kredikartelave bankare

KUJDES: Ju duhet të fotokopjoni dhe dorëzoni **VETEM PJESEN E PERPARME** të kartelës.

8) Dokumente që vërtetojnë qëndrime të mëhershme në hapësirën territoriale Schengen: fotokopje e vizave Schengen;

9) Dokumente që dëshmojnë mjetet e transportit: bileta e avionit vajtje/ardhje ose, nëse udhëtoni me makinë, fotokopje e qartë e dokumenteve të automjetit;

10) Sigurim shëndetësor ndërkombëtar; ai duhet të jetë i vlefshëm në të gjithë hapësirën territoriale të shteteve Schengen, duhet të mbulojë shpenzimet spitalore në rast së mundjeje dhe/ose aksidenti si edhe shpenzimet e nevojshme për riatdhesimin e kufomës në rast vdekjeje. Shuma siguruese minimale nuk duhet të jetë më e vogël se 30.000 Euro

AMBASADA ITALIANE PRISHTINE